



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË
BASHKISË SHKODËR”**

Konsultim publik : Rajoni nr.4.

Data : 22.09.2025

Ora : 13.00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 16, nga të cilat 2 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2026-2028 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Zv.Kryetarja e Bashkisë, e cila bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr fillimisht **Z.Arben Kallaçi**, administrator i Rajonit nr.4 i cili bën një përmbledhje të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.4 të qytetit.

Më pas fjalën e merr **Zv.Kryetarja e Bashkisë Znj.Qyteza**, e cila falënderon të pranishmit për të qenurit aktiv në këto takime. Kjo tregon, shton ajo edhe besueshmëri tek Bashkia dhe punët që realizojmë së bashku. Bashkia është shumë e interesuar që çdo zonë të jetë në fokusin e saj sipas nevojave që janë në terren. Ajo gjithashtu shton se për një kohë shumë të shkurtër kemi arritur të

bëjmë pune të mira dhe mirëpresim nga ju propozimet për buxhetin e ardhshëm të Bashkisë Shkodër.

Banor, rruga “Babej”:

- Rruga “Babej” ka nevojë për riveshje dhe riparim kunetash sepse janë dëmtuar nga kompanitë e internetit.

Z. Arian Muslia, banor rajoni nr.4:

- Në lagjen “Luguçesme”, nuk mund të aksesojmë në shtëpitë tona nga një parking makinash afër rrugës. Aty kemi edhe një kopësht dhe shkollë dhe bllokohet komplet rruga.
- Si qytetar kërkoj që rruga e Parrucës të kthehet me dy kalime sepse për të gjithë ne është shumë e vështirë lëvizja nëpër qytet me këtë rrugë me një sens. Njëlloj bëhet parkim për makinat, prandaj kështu siç është me një sens nuk ka mobilitet të mirë.

Nga administrata sqaron **Z.Altin Salihi** duke thënë se është e vërtetë problematika e rrugës në fjalë. Është vendosur një tabelë aty, por duhet të kemi me shpesh prezencën e Policisë Bashkiake në këtë rrugë. Po ashtu edhe rruga “Babej” ka nevojë për investim dhe duhet të përfshihet në buxhetin e vitit tjetër nga Bashkia

Z. Drini Bushati, përfaqësues i bizneseve tek pallati kinez:

- Pranë pallatit kinez ka nevojë për një riparim tashmë për të gjithë trotuarin dhe lulishten afër, gjithashtu ka një trotuar bri këtij pallati që duhet riparuar e sistemuar.
- Ai pyet edhe në lidhje me parkimit pas pallatit kinez nëse është menduar që të ketë edhe parkim si resident për banorët.

Z.Altin Salihi shprehet se lulishtja nuk është mirëmbajtur sepse ka qenë pjesë e lokaleve. Kurse për trotuarin do bëhet patjetër sistemi i të gjithë trotuareve. Gjithashtu ai fton të gjithë qytetarët që të jenë të pranishëm në takimin që do mbahet për planin e mobilitetit të qytetit të Shkodrës me kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Zv. Kryetaria e Bashkisë shton gjithashtu se një nga qëllimet e kësaj dëgjese është edhe të marrim nga ju ato propozime apo problematika të cilat ne nuk i kemi evidentuar, ndërkohë që planet e mëdha dhe projektet prioritare janë në vëmendjen tonë të vazhdueshme.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka **Znj.Teuta Qyteza**, Zv.Kryetare e Bashkisë mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti

SEKRETARE

Sabina Danaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË
(Lagjia nr.4)

KONSULTIM PUBLIK: "Për Miratimin e Projektbuxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Shkodër"

Data: 22.09.2025

NR.	EMRI MBEMRI	LAGJIA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1	Edmond Sume	4	0684803674	edmondsume@gmail.com	
2	Besjon Zolë	4	0698195455		
3	Hamdi Ibrahim	4	0677106140	hamditraceni@gmail.com	
4	Ervin Bideri	Koordinator	0694063981	ervin.dideri@postbox.shkoder.gov.al	
5	Erin Topa	Admistratori	0673788787	erintopa@gmail.com	
6	Flavio Malocaj	Bashkia Shkoder	0684063801	flavio.malocaj@bashkishtshkoder.gov.al	
7	Dometela Kelaj	Bashkia Shkoder	0673570001	dometelakelaj@bashkishtshkoder.gov.al	
8	ALTIN AHLETA	NRIFP	0682052150	altin.ahleta@postbox.shkoder.gov.al	

[illegible]